



Pranuar / Dorezuar Prinjeni/Pridato Received/Delivery	07-10-2022	2	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jednitca Org./Unit	Rr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPSHICK	5987	2022	115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.768/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.768/2022 të datës 05.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë vendbanimi Komuna e Gjakovës, kundër Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "Transfer-i për kohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.10.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.768/2022 e datës 05.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

**II.SHFUQIZOHET** Vendimi me numër protokolli 05-3998 i datës 15.08.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë.

**III. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë së Shëndetësisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën e tij sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 10.05.2017. me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën e punës „Zyrtar i Prokurimit“, në Divizionin e Prokurimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë, me datë 15.08.2022 me Vendimin me numër protokoli 05-3998 të Sekretarit të Përgjithshëm, është transferuar përkohësisht për periudhë gjashtë (6) muaj në pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa”, në Divizionin për Buxhet dhe Financa” në Ministrinë e Shëndetësisë.

Kundër Vendimit me numër protokoli 05-3998 të datës 15.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, ankuesi më datë 05.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se vendimi është nxjerre në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publika, Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, si dhe Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke propozuar që ti aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet vendimi i datës 15.08.2022 sepse është nxjerr në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe aktet nënligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 09.09.2022 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Ministria e Shëndetësisë. Me datë 16.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, prej 1/30 faqe.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa e datë 05.09.2022 me numër protokoli 5135/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 03.08.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm, derguar z.I.H, Njoftim për kontrata; E-mail i datës 03.08.2022 Njoftim, nga ankuesi për z.I.H; E-mail i datës 03.08.2022 Njoftim, nga z.I.H për ankuesin; E-mail i datës 02.08.2022 Njoftim, nga znj.MZ, për z.K.S, z.I.K dhe z.N.B; E-mail i datës 15.08.2022 për ankuesin nga znj.M.Z, bashkëngjitur ne attach Vendimin nr. 05-3998; Vendimi i datës 15.08.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrinë së Shëndetësisë, me numer protokoli 05-3998; Njoftim i datës 02.08.2022 me numër protokoli 05-3766 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë së Shëndetësisë për Udhëheqësin e Divizionit të Prokurimit, prej 1/2 faqe; Konfirmim i datës 21.07.2022 i rregullsisë së procesit të prokurimit dhe rekomandimit për nënshkrimin e kontratës “furnizim me barna dhe pajisje të imëta mjekësore për DSHB”, Lot 1, prej 1/2 faqe; Kontratë e datës 21.07.2022 publike kornizë 36 muaj për kontratës Furnizim me barna dhe pajisje të imëta mjekësore për DSHB- Lot 1, prej 1/16 faqe; E-mail i datës 03.08.2022 Njoftim nga ankuesi për z.I.H , z.R.N, z.N.B dhe z.M.Gj, të bashkëngjitur në atch dokument me numër 05-3766; E-mail i datës 03.08.2022 Njoftim nga z.I.H për ankuesin, dhe znj.E.SH; E-mail i datës 02.08.2022 Njoftim nga znj.M.Z, për z.K.S, znj.K.N, z.I.K , znj.L.K; Kontratë e datës 16.08.2022 publike kornizë 36 muaj për kontratës Furnizim me barna dhe pajisje të imëta mjekësore për DSHB- Lot II, prej 1/28 faqe; Njoftim për kontratë e datës 27.04.2022 prej 1/10 faqe; Njoftim për kontratë e datës 18.06.2019 prej 1/7 faqe; E-mail i datës 16.08.2022 Njoftim nga znj.M.K, për z.H.I, znj.K.B, z.I.H, cc per z.N.B, ankuesin dhe znj.V.K, me atch me numër 05-3998; E-mail nga z.I.H, per z.N.B, Njoftim për pushim mjekësor; E-mail nga z.N.B, per z.I.H, Njoftim-mase paralajmëruese vërejtje me shkrim në atch dokumenti me numër 05-3766 kontratë; Përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë e datës



16.09.2022 me numër protokoll 5455/2022 prej 1/30 faqe për KPMSHCK; Akt emërimi i datës 03.07.2012; Ndryshim dhe Plotësim i Akt emërimit i datës 10.05.2017 për ankuesin; Raporti i punës prej datës 01.01.2022 deri me datës 15.08.2022 nga ankuesi; Planifikimi përfundimtar i prokurimit i datës 12.01.2022 për vitin fiskal 2022 prej 1/13 faqe; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, i datës 31.12.2021 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020, i datës 11.02.2021 për ankuesin; E-mail i datës 12.08.2022 për informim nga z.N.B, për z.H.I, znj.M.K, znj.K.B; E-mail i datës 12.08.2022 nga znj.K.B, për z.N.B, znj.M.K, informim për mungesë të stafit në financa; E-mail i datës 12.08.2022 informim nga znj.K.M për znj.K.B, në pritje të sistemimit në një organizatë tjetër.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Ndryshim dhe Plotësim të Akt emërimit të datës 10.05.2017, ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, në pozitën e punës „Zyrtar i Prokurimit“ ndërsa i njëjti me Vendimin me numër protokoll 05-3998 të datës 15.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë është transferuar përkohësisht në pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa“, në Divizionin për Buxhet dhe Financa, për periudhë gjashtë (6) muaj me arsyetimin në interes të organizimit dhe funksionalizimit të Divizionit për Buxhet dhe Financa.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi i punësimit me rastin e transferimit të përkohshëm të tij ka vendosur në mënyrë të gabuar dhe jo të drejt duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe ligjeve tjera relevante.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se: “Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”, dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 te të njëjtit ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetence të njësisë përgjegjëse.*

Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësi përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë është Njësia për Burime Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do

të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi për transferimin e ankuesit nga pozita e punës „Zyrtar i Prokurimit,” në Divizionin e Prokurimi në pozitën e punës „Zyrtar për Buxhet dhe Financa” në Divizionin për Buxhet dhe Financa”, nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës nga organi i punësimit nuk është dhënë asnjë arsyetim në lidhje me marrjen e kompetencës së njësisë përgjegjëse nga udhëheqësi me i lartë administrativ. Andaj në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura si dhe bazuar në këtë konstatim, Kolegji i Këshillit vlerëson se vendimi për transferimin e përkohshëm të ankuesit, respektivisht akti i kontestuar me numër protokollit 05-3998 i datës 15.08.2022 është nxjerr nga organi jo kompetent përkatësisht vendimi është nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm e jo nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore si organ kompetent, dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj mbi këtë baze pretendimi ankimor i ankuesit është i drejt dhe i bazuar.

Po ashtu nga vendimi i kontestuar me ankesë, Kolegji i Këshillit, ka gjetur që nuk ka prova të mjaftueshme të cilat determinojnë që me këtë transferim është bërë organizimi dhe funksionalizimi i Divizionit për Buxhet dhe Financa, rrjedhimisht organi i punësimit nuk ka ofruar dëshmi dhe prova të mjaftueshme për të argumentuar dhe dëshmuar se ky divizion ka gene jofunksional, përkundrazi në bazë të dëshmisë të ofruar nga ankuesi respektivisht e-malit të datës 17.08.2022 të Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm konfirmohet fakti se me transferimin e tij do të pamundësohej arritja e objektivave të Divizionit, rrjedhimisht aktivitetet e prokurimit me të cilat është i ngarkuar ankuesi do të mbesnin te papërfunduara dhe kjo do të krijonte vështirësi në përmbylljen e lendeve sipas planit të prokurimit, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstatoi se vendimi i kontestuar me ankesë nuk është nxjerr si rezultat i argumentimit të provave dhe i njëjti në këtë kuptim është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokollit 05-3998 i datës 15.08.2022 është akt administrativ i paligjshëm, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi për aprovimin e ankesës dhe rrjedhimisht shfuqizimin e aktit administrativ të kontestuar, duke detyruar njëkohësisht organin e punësimit që ankuesin ta kthejë në pozitën e tij sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 10.05.2017 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.




Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.768/2022.**

Zyle Millaku GOJNOVCI

  
Procesmbajtëse



Malsore GASHI BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së .